

1.6



REPUBLIKA E SHQIPERISE
Keshilli i Ministrave

PROJEKTVENDIM

Nro _____, date _____

PER

PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT "PER SHERBIMIN
SHENDETESOR STOMATOLOGJIK NE REPUBLIKEN E
SHQIPERISE"

Ne mbeshtetje te neneve 81, pika 1, dhe 100, te Kushtetutes, me propozimin e ministrit te Shendetesise, Keshilli i Ministrave

VENDOSI:

Propozimin e projektligjit "Per sherbimin shendetesor stomatologjik ne Republiken e Shqiperise", per shqyrtim e miratim ne Kuvendin e Republikes se Shqiperise, sipas tekstit dhe relacionit, qe i bashkelidhen ketij vendimi.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

KRYEMINISTRI

SALI BERISHA

1.

2.



**REPUBLIKA E
SHQIPERISE
Kuvendi**

PRO J E K T L I G J

Nr. _____, date _____

—

PER

**SHERBIMIN SHENDETESOR STOMATOLOGJIK NE
REPUBLIKEN E SHQIPERISE**

Ne mbeshtetje te neneve 78 dhe 83, pika 1, te Kushtetutes, me propozimin e Keshillit te Ministrave, Kuvendi i Republikes se Shqiperise

VENDOSI:

KREUI

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Qllimi dhe fusha e zbatimit

3. Ky ligj ka per qellim te percaktoje rregullat per organizimin dhe funksionimin e sherbimit shendetesor stomatologjik ne Republiken e Shqiperise.

4. Ky ligj zbatohet nga/ndaj personative, fizike dhe juridike, vendas ose te huaj, te cilet ushtrojne veprimtari ne fushen e sherbimit shendetesor stomatologjik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 2

Financimi i shërbimit shëndetësor stomatologjik publik

1. Në institucionet e shërbimit shëndetësor stomatologjik publik ofrohet falas shërbimi, profilaktik dhe mjekues, stomatologjik, për:

- a) personat nga moshë 0 deri 18 vjeç;;
- b) të shtuarit dhe ata që trajtohen në institucione spitalore publike, për mjekime urgjence;
- c) kategori të veçanta individesh, që, me ligje dhe akte nenligjore të veçanta, përfitojnë shërbim shëndetësor stomatologjik falas.

2. Shteti merr përsipër të mbulojë pjesërisht:

- a) shërbimin e urgjencave stomatologjike, për moshat mbi 18 vjeç;;
- b) shërbime stomatologjike, në Departamentin e Stomatologjisë, në Fakultetin e Mjekësisë;
- c) Shërbime stomatologjike në institucionet stomatologjike publike.

3. Masa dhe mënyra e kontributit të shtetit për shërbimet e parashikuara në pikën 2, të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.



1. Shërbimi i urgjencës stomatologjike ofrohet në:

Neni 3

Shërbimi i urgjencës stomatologjike

- a) institucionet publike shëndetësore spitalore;
- b) institucionet publike shëndetësore stomatologjike ambulatorë.

2. Në ato institucione shëndetësore, ku nuk mund të ofrohet shërbimi i urgjencës, sipas pikës 1, të këtij neni, lidhen kontrata shërbimi me subjekte, që ofrojnë shërbim stomatologjik privat.

Neni 4

Shërbimi shëndetësor stomatologjik në institucionet arsimore

1. Shërbimi profilaktik, diagnostikues dhe edukimi shëndetësor stomatologjik ofrohen në të gjitha institucionet arsimore të nivelit të detyrueshëm.

2. Ministria e Shendetesise dhe Ministria e Arsimit dhe Shkences nxjerrin udhezimin e perbashket per funksionimin dhe organizimin e ketij sherbimi, ne keto institucione arsimore.

KREUI

INSTITUCIONET SHENDETESORE STOMATOLOGJIKE, ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I TYRE

Neni 5

Institucionet, qe ofrojne sherbim shendetesor stomatologjik

1. Sherbimi shendetesor stomatologjik ofrohet nga:
 - a) institucionet shendetesore stomatologjike publike.
 - b) institucionet shendetesore stomatologjike private.
2. Menyra e organizimit dhe e funksionimit te institucioneve shendetesore stomatologjike percaktohen me urdher te ministrit te Shendetesise.

Neni 6

Licencimi

1. Te gjithe personat, fizike dhe juridike, qe ushtrojne veprimtarine ne sherbimin shendetesor stomatologjik, licencohen prane Ministrise se Shendetesise ose autoriteteve te autorizuarra prej saj.
2. Te gjitha subjektet e licencuara, qe e ushtrojne veprimtarine ne fushen e stomatologjise, jane te lira te bejne publicitet, duke qene transparente dhe ne perputhje me te drejten, qe i njeh ky ligj dhe aktet nenligjore, ne zbatim te tij.
3. Procedurat dhe kriteret e licencimit percaktohen me vendim te Keshillit te Ministrave.

Neni 7

Personeli i sherbimit shendetesor stomatologjik

1. Sherbimi shendetesor stomatologjik ofrohet nga personeli:

- a) mjek stomatolog;
- b) ndihmesmjek stomatolog;
- c) laborant dentar.

2. Personeli i sherbimit shendetesor stomatologjik e ushtron veprimtarine ne perputhje me rregullat e miratuara nga ministri i Shendetesise.

KREU III

MBIKEQYRJA NE SHERBIMIN SHENDETESOR STOMATOLOGJIK

Neni 8 Mbikeqyrja

Mbikeqyrja ne sherbimin shendetesor stomatologjik kryhet nga Inspektorati Shendetesor Stomatologjik.

Neni 9 *f* Inspektorati Shendetesor Stomatologjik

1. Ne varesi te Ministrise se Shendetesise organizohet dhe funksionon Inspektorati Shendetesor Stomatologjik.
2. Inspektorati Shendetesor Stomatologjik eshte organi ekzekutiv, i specializuar per kontrollin e zbatimit te ketij ligji dhe te akteve nenligjore, qe rregullojne sherbimin shendetesor stomatologjik.
3. Struktura dhe organika e Inspektoratit Shendetesor Stomatologjik miratohen nga Kryeministri, me propozimin e ministrit te Shendetesise.
4. Rregullat e funksionimit te Inspektoratit Shendetesor Stomatologjik miratohen nga ministri i Shendetesise.

KREUIV

KUNDERVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 10

1. Kur nuk perbejne veper penale, shkeljet e meposhtme perbejne kundervajtje administrative dhe denohen:

- a) Shkelja e nenit 6, me gjobe 50 000 leke dhe me nderprerje te veprimtarise, deri ne plotesimin e dokumentacionit, sipas _ legjislacionit ne fuqi.
- b) Shkelja e rregullave, te permendura ne piken 2, te nenit 7, te ketij ligji, me gjobe deri ne 50 000 leke dhe, ne rast perseritjeje, me mbyllje te veprimtarise.

2. Autoriteti pergjegjes per venien dhe ekzekutimin e gjobave eshte Inspektorati Shendetesor Stomatologjik.

Neni 11

Ankimi

Procedurat per yemen e gjobave per kundervajtjet administrative, dhe ankimi per to behen ne perputhje me ligjin nr.7679, date 7.4.1993, "Per kundervajtjet administrative", te ndryshuar.

KREU V

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 12

Nxjerrja e akteve nenligjore

1. Ngarkohet Keshilli i Ministrave te nxjerre aktet nenligjore ne zbatim te neneve 2, pika 3, dhe 6, pika 3.
2. Ngarkohet ministri i Shendetesise te nxjerre urdherat, ne zbatim te neneve 5, pika 2, 9, pika 4, dhe 7, pika 2.

3. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës, që, në zbatim të pikës 2, të nenit 4, të nxjerre udhezimin e përbashkët me Ministrinë e Shëndetësisë.

Neni 13
Shfuqizime

Ligji nr.8167, datë 21.11.1996, "Për shërbimin shëndetësor stomatologjik", i ndryshuar, si dhe aktet e tjera, që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 14
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në "Fletorën zyrtare".

KRYETARI

JOZEFINA TOPALLI